REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
Nr. Prot. 1-180/2710
Nr. Fag. 3
Data 28/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zeqë Hebibi zyrtar administrativ i zyrës së Kryetarit

LISTA E VENDIMEVE TE MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNES SË JUNIKUT

Nr	Titulli i vendimit	Data	Protokolli
1	**Vendim, përfundohet marrëdhenia e punës së ushtruses së detyrës**	**06/01/2023**	**01-180/01/184/2023**
2	**Vendim, zëvensdësues i udhëheqësi sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale**	**11/01/2022**	**01-180/01/336/2023**
3	**Vendim, formohet grupi punues për klasifikimin**	**06/01//2023**	**01-180/01/197/2023**
4	**Vendim, për lejimin e qasjeve në SIMFK pëe 2023**	**11/01/2023**	**01-180/01/365/2023**
5	**Vendim, për themelimin e komisionit të rekrutimit**	**24/01/2023**	**01-180/01/838/2023**
6	**Vendim, për emërimin e ekipit shqyrtues për heqjen/ shitjen e aseteve**	**31/01/2023**	**01-180/01/966/2023**

7	**Vendim, për caktimin e grupit punues për hartimin e projekt-buxhetit**	**31/01/2023**	**01-180/01/967/2023**
8	**Vendim, për pagesën jasht orarit të rregullt të punës**	**01/02/2023**	**01-180/01/1007/2023**
9	**Vendim, Themelimi i komisionit te perkohshem per shqyrtimin dhe vleresimin e kerkesave per ndarjen e subvencioneve.**	**10.02.2023**	**01-180/01/1296/2023**
10	**Vendim, Aprovohet kerkesa per riatdhesim nga Shteti i Gjermanise, per vazhdim te akomodimit me qira per 12 muaj.**	**06.02.2023**	**01-180/01/1094/2023**
11	**Vendim, perfundimi i mandatit sipas kontrates se punes me nr. 15/2019.**	**09.02.2023**	**01-180/01/1253/2023**
12	**Vendim, emerimi si zevendesues ne poziten e punes si Koordinator i cilesise ne QKMF.**	**09.02.2023**	**01-180/01/1254/2023**
13	**Vendim, Formimi i grupit punes per hartimin e planit per transparence komunale.**	**23.01.2023**	**01-180/01/782/2023**
14	**Vendim, themelimi i komisionit per perzgjedhjen e kadnidateve te cilet kane konkurruar ne vendin e punes: Teknik Laborant/e i/e mjeksise dhe poziten Vozites ne QKMF.**	**14.02.2023**	**01-180/01/1386/2023.**
15	**Vendim per subvencionim.**	**01.03.2023**	**01-180/01/1828/2023**
16	**Vendim, caktimi i zyrtarit zevendesues per qertefikimin dhe aprovimin e lendeve per pagesa.**	**01.03.2023**	**01-180/01/1825/2023**
17	**Vendim, pushim pa pagese**	**01.03.2023**	**01-180/01/1826/2023**
18	**Vendim per largim nga pozita zyrtar per mardhenie me publikun**	**01.03.20230**	**01-180/01/1827/2023**
19	**Vendim emertimi i zv. per poziten e drejtorit te shkolles fillore.**	**09.03.2023**	**01-180/01/2109/2023**
20	**Vendim, themelimi i komisionit per ngritjen ne detyre per poziten Udheheqes i sektorit te**	**14.03.2023**	**01-180/01/2203/2023**

	Tatimit ne Prone, ne Drejtorine per Buxhet dhe Financa.		
21	**Vendim, caktohet zevendesuesja e udheheqesit te prokurimit.**	**17.03.2023**	**01-180/01/2287/2023.**
22	**Vendim,për përfundimin e marredhenies së punës**	**21.03.2023**	**01-180/01/2340/2023**
23	**Vendim,me anë të këtij vendimi ndryshohet-ploësohet Vendimi nr.01/71**	**17.03.2023**	**01-180/01/2310/2023**
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/24
Datë: 29.03.2023

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, në bazë të nenit 23 të ligjit nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L092 si dhe në bazë të nenit 61.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, nxjerrë këtë vendim:

V E N D I M

I. Anulohet Vendimi për emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Kontratës me nr. të protokollit 1-180/6014, i datës: 25.07.2022, për mbikëqyrjen e aktivitetit të prokurimit me titull: Shërbime Juridike për nevojat e Komunës së Junikut, me numër të prokurimit: 636-22-5359-2-2-1, dhe numri i brendshëm i prokurimit: 636-22-017-221.

II. Flurije Shehu- Zyrtare e Lartë për Kadastër, caktohet Menaxhere e Kontratës.

III. Ferdone Tofaj- Zyrtare e Lartë për Planifikim, caktohet si mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e Menaxherit të Kontratës.

IV. Emërimi në paragrafin 2 dhe 3 i këtij vendimi vjen si pasojë e shkëputjes nga puna e menaxherit të kësaj Kontrate e caktuar si person adekuat për menaxhimin e këtij aktiviteti.

V. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzimit operativ për Prokurimin Publik nr. A01, si dhe Manualet për përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

VI. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim njoftohen:

- Menaxheri i Kontratës
- Mbikëqyrësja e drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës
- Zyra e Prokurimit
- Drejtoria përkatëse
- Arkivi i Komunës

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/2310
Nr. I faq.
Data 17/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/23
Datë: 17.03.2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 42 paragrafi (i) dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kryetari i Komunës me datë 17.03.2023, merr këtë:

VENDIM

I. Me anë të këtij vendimi ndryshohet-plotësohet **Vendimi nr.01/71** me numër të protokolit **1-180/5705** i datës 15 Korrik 2022.

II. Caktohet z.Esat Hoxha procesmbajtës i mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Junikut.

III. Zyrtari i përmendur në pikën e II-të të këtij Vendimi, do të përpiloj procesverbalin e Kuvendit Komunal të Junikut jashtë orarit të punës për gjithsej 10 (dhjetë) orë në muaj, ky vendim vlen deri në një vendim tjetër të marrë nga Kryetari.

IV. Kjo përgjegjësi i jipet si detyrë shtesë zyrtarit në fjalë.

V. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtori për Administratë të Përgjithshme,
- Zyrtari z.Esat Hoxha,
- Arkivi i Komunës së Junikut.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/OFFICE OF THE MAYOR
JUNIK

Kryetari i Komunës

/ Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/2340
Nr. Faq. 1
Data 21/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/22
Datë:20.03.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës: 29.9.2010, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 5 dhe neni 44 të, Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 62 paragrafi 1, Kryetari i Komunës me datë: 20.03.2023 merr ketë:

VENDIM

I. Për përfundimin e marredhenies së punës së znj.Venera Shala e sistemuar në vendin e punës Udhëheqëse e Personelit në Komunën e Junikut.

II. Përfundimi i marredhenies së punës bëhet sipas dorëheqjes së zyrtarës në fjalë e cila është avancuar në pozitën Prokuror i Shtetit të Republikës së Kosovës me Dekretin e Presidentes së Shtetit të datës 15.03.2023.

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Pala,
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KRYETARIT/MUNICIPALITY OF JUNIK/THE MAYOR'S OFFICE
ZYRA E KRYETARIT/ZYRTARIA PREDSEDNIKA
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/2287
Nr. i faq. 1
Data 17/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/21
Datë:09.03.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 53 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pershtatshmerisht në dispozitat ligjore të nenit 20 paragrafi 3 të Ligjit numër 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Zyren e Prokurimit Publik, merr ketë:

V E N D I M

I. Me kete Vendim **znj. Florinda Kukalaj** e sistemuar Zyrtare e Prokurimit, caktohet **zëvendësuese e Udhëheqësit të Prokurimit**, nga data: 08.03.2023, që të punoj me kompetenca dhe pergjegjesi të plota.

II. E lartpërmendura në pikën I të këtij vendimi, në ketë periudhë ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform Ligjit nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

III. **znj. Florinda Kukalaj** edhe gjatë vitit 2022, ka qenë e angazhuar **zëvendësuese e Udhëheqësit të Prokurimit** sipas nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë megjithatë në mungesë të stafit të kualifikuar do të emerohet prap në zevendesuese në vendin e punës të **Udhëheqësit të Prokurimit**

IV. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Znj. Florinda Kukalaj,
- Zyra e Personelit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/OFFICE OF THE MAYOR
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-155/2023
Nr. i faq. 1
Data 14.03.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/20
Datë: 14.03.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 39 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 59 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës, me datë 14.03.2023 nxjerrë :

V E N D I M

I. Themelohet komisioni i vlerësimit për ngritje në detyrë, për pozitën Udhëheqës i Tatimit në Pronë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

II. Komisioni ka këtë përbërje:

1. Demë Ukaj – U.D Udhëheqës për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, **Valbona Gaxherri (zevendesues) – Zyratre për arsim,**
2. Arton Krasniqi – Zyratr i Lartë për Arsim - anëtar i komisionit, **Avdyl Maloku (zevendesues) – Zyrtar i Zhvillim Ekonomik,**
3. Sundim Krasniqi - Zyrtar për Buxhet dhe Financa - anëtar i komisionit, **Bashkim Gaxherri (zevendesues) – Zyrtar për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.**

III. Detyrat dhe pergjegjesitë e komisionit janë të percaktuara sipas Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 59 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Zyra e personelit,
2. Anëtarët e komisionit,
3. Arkivi komunal.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/THE MAYOR'S OFFICE
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 4-180/2109
Nr. i faq. 1
Data 09/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/19
Datë: 09.03.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në SHFMU „ Edmond Hoxha ", Kryetari i Komunës me datë: 09.03.2023, merr ketë:

V E N D I M

I. Pas përfundimit të mandatit të Drejtorit në SHFMU „ Edmond Hoxha " në Junik, me datë: 09.03.2023, **znj. Bekije Jasiqi** emerohet zevendesuese në ketë pozitë nga data: 10.03.2023, që të punoj me kompetenca dhe pergjegjesi të plota deri në perzgjedhjen e drejtorit sipas procedurave të rekrutimit.

II. E lartpërmendura në pikën I të këtij vendimi, në ketë periudhë vazhdon me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform legjislacionit në fuqi për fushën përkatëse.

III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- **znj. Bekije Jasiqi**
- Drejtoria për AKRS
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
KANCELARIA PRESDSEDNIKA/THE MAYOR'S OFFICE
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/1827
Nr. i faq.
Data 01/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/18
Datë:01.03.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës: 29.9.2010, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 5 dhe neni 44 të, Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 78 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, Kryetari i Komunës me datë: 01.03.2023 merr ketë:

VENDIM

I. Nëpunësi i kabinetit Arton Gaxherri i emëruar në vendin e punës **Zyrtar për Marredhenie me Publikun** lirohet nga detyra nga data: 01.03.2023.

II. Lirimi nga detyra bëhet mbi bazen e vullnetit të zyrtarit Arton Gaxherri për tu liruar nga detyra dhe pergjegjesitë e vendit të punës si Zyrtar për Marredhenie me Publikun.

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Udhëheqësja e personelit,
- Pala,
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E KRYETARIT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/THE MAYOR'S OFFICE
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK, OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
OZ/Nr. Prot. 1-180/1826
Nr. i faq.
Data 01/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/17
Datë: 01.03.2023

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03-L/040, në bazë të nenit 18 pika 4 dhe 5 të Ligjit për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës nr.06/L-114, nenit 40 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, nenit 14 pika 2.2 të Rregullores nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë si dhe kërkesës së nëpunëses Shiqerie Thaqi të datës 15.02.2023, Kryetari i Komunës me datë: 01.03.2023 merr këtë:

VENDIM

I. Aprovohet kërkesa e **znj.** Shiqerie Thaqi – Zyrtare Çertifikuese -Aprovuese në Komunën e Junikut për marrjen e pushimit pa pagesë në periudhë prej tre (3) muaj.

II. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi I. i këtij Vendimi, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit.

III. Pushimi pa pagesë do të filloi prej datës: 01.03.2023 deri me 31.05.2023, i përmenduri duhet të lajmërohet ne punë me datë: 01.06.2023.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Pala,
2. Drejtoria për AP,
3. Zyra e personelit,
4. Arkivi komunal.

K r y e t a r i:
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

07-180/1825
01/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/16
Datë: 01.03.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, me datë: 01.03.2023, Kryetari i Komunës merr ketë:

V E N D I M

I. **z. Avdyl Maloku** i sistemuar në pozitën e punës Zyrtar për Zhvillim Ekonomik në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, caktohet **zëvendësues i Zyrtarit Qertifikues - Aprovues**, nga data: 01.03.2023, që të punoj me kompetenca dhe pergjegjesi të plota deri në kthimin e zyrtares nga pushimi pa pagesë.

II. I lartpërmenduri në pikën I të këtij vendimi, në ketë periudhë ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform legjislacionit në fuqi për fushën përkatëse.

III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- z. Avdyl Maloku,
- Zyra e Personelit,
- Drejtoria për B.F,
- Drejtoria për E.ZH,
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01-180/1828
01/03/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/15
Datë: 01.03.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 8 paragrafi 6 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, kërkesës me nr.1-155/1408, të datës: 15.02.2023 dhe Raportit të Komisionit për ndarjen e subvencioneve për vitin 2023 me nr. protokolli 1-180/1807, të datës: 01.03.2023, Kryetari i Komunës me datë:01.03.2023, merr ketë:

V E N D I M

I. Me të cilin ndanë shumen e mjeteve në vlerë prej 500 €, për _ i cili identifikohet me nr. Personal _ i cili ka kërkuar për ndihmë veten e tij dhe i cili vuan nga një sëmundje e rëndë dhe i nevojitet urgjent operimi.

II. Shuma e përmendur ne piken I të këtij vendimi do të realizohet nga kategoria Subvencione, dhe mjetet do te barten ne llogarinë bankare të me nr. në Bankën Ekonomike.

III. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me Vendim njoftohen:

E lartpërmendura në pikën I. të Vendimit,
Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK/ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/OFFICE OF THE MAYOR
JUNIK

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/1386
Nr. I faq.
Data 14/02/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/14
Datë:14.02.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 68 paragrafi 7 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Kryetari i Komunës më datë 14.02.2023, nxjerrë:

V E N D I M

I. Themelohet komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në vendin e punës: **Teknik Laborant/e i/e Mjeksisë,** dhe vendin e punës: **Vozitës,** në **QKMF „Dr. Ali Hoxha në Junik''.**

II. Komisioni ka këtë përbërje:

1. Skender Bajraktari (Mjek pediatër), kryesues i komisionit,
2. Sevdie Rexha (U.D Kryemotër) anëtare e komisionit,
3. Demë Ukaj –(U.D Udhëheqës i Sektorit për SHMS) anëtarë i komisionit.,
4. Saranda Isufaj (U.D Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë) anëtare e komisionit,
5. Sundim Krasniqi (Zyrtar për Buxhet dhe Financa) anëtarë e komisionit.

III. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e kandidatëve në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi.

<u>Me këtë vendim njoftohen:</u>

- Anëtarët e komisionit
- Zyra e personelit dhe arkivi

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA KOSOVË – ZYRA E KRYETARIT – REPUBLIC OF KOSOVA – THE MAYOR'S OFFICE
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 1-180/782
Një. Org 1
Nr. i Iaq. 1
Data 23/01/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/13
Datë: 23.01.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës: 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me datë 23.01.2023 merr ketë:

VENDIM

I. Formohet grupi punues për Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale me përbërje si në vijim:
   1. Rrustem Pepshi – kryesues i grupit punues,
   2. Xhevahire Krasniqi – anëtare,
   3. Sundim Krasniqi – anëtarë.

II. Të përmendurit në pikën I të këtij vendimi ngarkohen me detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigurues i zbatimit të Planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlidhet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Mbikëqyrë zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e Planit të Veprimit për Transparencë;

III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtareve të komisionit,
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-182/1296
Nr. i faq. 1
Data 10/02/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPSTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/12
Datë:10.02.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040. nenit 43 te Statusit të Komunës së Junikut, dhe nenit 7 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës me datë : 10.02.2023, merr ketë:

Vendim

1. Për themelimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.

1. Rrustem Pepshi - Zyrtarë i IT- Kryesues i komisionit,
2. Dukagjin Llolluni- OJQ "Kuvendi i Junikut- anëtarë
3. Valbona Gaxherri- Zyrtare për Arsim - anëtare
4. Saranda Isufaj - Zënvendesuese e udhëheqesit të tatimit në pronë- anëtare,
5. Arton Krasniqi - Zyrtarë i Latë për Arsim- anëtarë,

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë te përcaktuara me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

III. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

1. Anëtaret e komisionit,

2. Arkivi komunal.

Kryetari i Komunës

Z. Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KABINETI/OFFICE OF THE MAYOR/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/THE MAYOR'S OFFICE
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/1254
Nr. i faq. 1
Data 09/02/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/11
Datë:08.02.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës: 29.9.2010, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 5 dhe neni 44 të, Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 66 paragrafi 2, përshtatshmerisht Ligjit Nr. 03/L-212 I Punës, neni 17 paragrafi 2, Ligji Nr. 04/L-125, Kryetari i Komunës me datë: 08.02.2023 merr ketë:

VENDIM

I. Dr.Skender Bajraktari – Specialist i Pediatrisë, me Nr. personal. emerohet zevendesues në pozitën e punës **Koordinator i cilësisë në QKMF „ Dr.Ali Hoxha"** në Junik nga data 09.02.2023, deri në përzgjedhjen e Koordinatorit sipas procedurave të rekrutimit.

II. I permenduri në pikën një (I) të këtij Vendimi do të ketë koeficientin e pagës sipas titullit të zevendesimit **Kordinator i cilësisë në QKMF.**

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Udhëheqësja e personelit,
- Pala,
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA OPŠTINE/MAYOR'S OFFICE
JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-185/1253
Nr. I faq.
Data 09/02/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/10
Datë:08.02.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 4, 5 dhe neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Kontratës së punës me Nr.15/2019 të datës: 07.06.2019, Kryetari i Komunës me datë: 08.02.2023 merr ketë:

VENDIM

I. Përfundon mandati sipas Kontratës së punës me Nr.15/2019 të datës: 07.06.2019, për **Dr. Sadik Nitaj** me Nr. personal. në pozitën e punës **Koordinator i cilësisë, në QKMF„ Dr.Ali Hoxha"** në Junik, dhe njëkohësisht i njejti kthehet në pozitën e mëparshme të punës Mjek – Specialist i Mjeksisë Familjare.

II. I permendurI në pikën një (I) të këtij Vendimi do të ketë koeficientin e pagës sipas titullit të vendit të punës Mjek – Specialist i Mjeksisë Familjare.

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Udhëheqësja e personelit,
- Pala,
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KABINETI I KRYETARIT/OFFICE OF THE MAYOR
JUNIK

Komuna e Junikut,
Zyra e Kryetarit.
Nr.01/09/2023.
Datë: 03.02.2023.

Bazuar në nenin 4 (pika 1), nenin 21 (pika1, 3 dhe 4) nenin 33 (pika 2 dhe 6), nenin 44 (pika 1,4 dhe 4.1) të Rregullores QRK nr. 22/2020 për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar si dhe vendimin e Kryetarit të Komunës së Junikut për themelimin e Komisionit Komunal për Ri integrim, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni Komunal për Ri integrim nxjerr:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa me nr. prot: 1-155/821, i të riatdhesuarit nga shteti i Gjermanisë, me datë 15.01.2021, për mbështetje nga programi emergjent i Ri integrimit për vazhdim të **akomodim me qira edhe për 12 muaj**, në vlerë prej **180 € duke përfshirë edhe shpenzimet komunale nga ana e qiradhënësit**, sipas lëndës/kërkesës së parashtruar nga Zyra për Integrime Evropiane dhe Kthim të Komuniteteve në Komunën e Junikut.

II. Përfitues nga pika I e këtij Vendimi është i riatdhesuari **Domenik Shehu**, nga Komuna e Junikut.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.

IV. Për ekzekutimin e pagesës së qirasë sipas këtij vendimi obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

V. Shfuqizohet Vendimi Nr.01/14/2022, i datës 27.01.2022, me nr. prot.1-180/764.

VI. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m :

Komisioni Komunal për Ri-integrim, në mbledhjen e mbajtur më datë 03.02.2023, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar me datë 24.01.2023, nga i riatdhesuari **Domenik Shehu** Komuna e Junikut, për përfitim nga masat emergjente të Ri-integrimit për vazhdim të **akomodimit me qira** dhe ka konstatuar se është i domosdoshëm vlerësimi i vazhdimit të **akomodimit me qira** nga ana e Qendrës për Punë Sociale në Junik.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-189-1007
Nr. i faq.
Data 01/02/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/08
Datë:01.02.2023

Në bazë në Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 13 Statutit të Komunës së Junikut nenit 43, dhe në në meshtetje të Ligjit Nr.03/L-147 Për Pagat e Nëpunësve Civil neni 21 paragrafi 1 2 lidhur me nenparagrafet 2.1 dhe 2.3, si dhe nenit 7 paragrafi 1,2,3,4,5,6 të Rregullores (Qrk) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, Kryetari i komunës me datë: 01.02.2023, merre këtë:

V E N D I M

Për pagesën jasht orarit të rregullt të punës

I. Punëtori teknik **Fatmir Goçi** i emeruar në vendin e punës **Mirembajtës të Higjienes** në SHFMU „Endmond Hoxha""në Junik, autorizohet për kryerjen e punës shtesë jashtë orarit.

II. I përmenduri në paragrafin I të këtij Vendimi do të punojë nga dita e hënë deri në ditën e premte prej orës 6:30 deri në ora 8:00 për përkujdesjen e ngrohjes në shkollë duke filluar nga data: 01.02.2023 deri me 30.04.2023.

III. Puna Jasht orarit do të kompensohet në harmoni me Rregulloren (Qrk) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë neni 7 paragrafi 2 dhe neni 3 nenparagrafi 3.1.

IV. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Pala,
2. Drejtoria e SHFMU "Edmond Hoxha"
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
4. Zyra e Personelit,
5. Arkivi komunal.

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
OPŠTINA JUNIK
I
JUNIK

K r y e t a r i:
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVt'S - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT-OI'S'HNA JUNIK - MUNICIPALI'I Y OF JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 01-180-967
Nr. i faq. 1
Data 31/01/2023

Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut
Vendimi nr. 01/07
31 Janar 2023, Junik

Bazuar në nenin 58 paragrafm g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 42 paragrafin i) si dhe nenin 43 të Statutit të Komunës së Junikut nr. 001/3/27 të datës 30.09.2010, Kryetari i Komunës së Junikut merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024-2026

I. **Caktohet** Grupi Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024-2026, në këtë përbërje:

1. Arten Hamza- Zyrtari Kryesor Financiar, Kryesues
2. Florant Pepshi- Drejtoria Për Buxhet dhe Financa, Anëtar
3. Valbona Gaxherri- Drejtoria për Arsim Kultur Rini dhe Sport. Anëtare
4. Deme Ukaj- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Anëtar
5. Avdyl Maloku- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Anëtar
6. Ferdone Tofaj- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Anëtare
7. Turim Ganijaj- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion, Anëtar
8. Sundim Krasniqi- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Anëtar
9. Rrustem Pepshi- Zyrtar i IT-se, Anëtar

II. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Junikut për vitin 2024-2026, të bëjë hartimin e Planit të Brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publik, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetorë dhe ta dërgoj në Kuvendin Komunal.

III. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

IV. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

V. Obligohet Grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024-2026.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/OFFICE OF THE MAYOR
JUNIK

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

Vendimi i dërgohet:

1. Anëtarëve të Grupit Punues,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
3. Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 01-180-966
Nr. i fax.
Data 31/01/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/06
Datë: 31.01.2023

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Numër. 03/L-040, Neni 13, Neni 43 në Statutin e Komunës së Junikut, të datës 29.10.2010, rekomandimeve të pranuara nga raporti i komisionit për Inventarizim e pasurive jo financiare, të datës: 12.12.2022 dhe komisionit për Vlerësim të pasurive jo financiare të datës 10.01.2023, kryetari i Komunës me datë: 31.01.2023, merr këtë:

V E N D I M

I. Për emërimin e ekipit shqyrtues për heqjen/shitjen e aseteve në Komunën e Junikut. Ky ekip përbëhet prej pesë anëtarëve:

1. Zenun Shala- Kryesues
2. Arian Xhuli- Anëtar
3. Saranda Isufaj- Anëtare
4. Sundim Krasniqi- Anëtar
5. Behar Fetaj- Anëtar
6. Vjollca Qestaj- Anëtare

II. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara sipas rregullave për shitjen dhe heqjen e aseteve, të përçaktuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, dhe në rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

III. Ky vendim Hyn në Fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim njoftohen:

Të lartpërmendurit në pikën I të vendimit,
Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Arkivi

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/838
Nr. i faq.
Data 24/01/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/05
Datë:24.01.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 68 paragrafi 7 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Kryetari i Komunës me datë: 24.01.2023, nxjerrë:

V E N D I M

I. Për themelimin e **komisionit të rekrutimit,** për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë konkuruar në vendin e punës Asistent/e për femijë – nxënës me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU „Edmond Hoxha " në Junik.

I. Komisioni do të këtë përbërjen si në vijim:

1. Demë Ukaj –(Zyrtar administrativ financiar) Kryesues i komisionit,
2. Saranda Isufaj (U.D Udhëheqëse e tatimit në pronë) anëtare e komisionit,
3. Sundim Krasniqi – Zyrtar për Buxhet dhe Financa - anëtar i komisionit,
4. Xhevahire Krasniqi – Zyrtare për Barazi Gjinore - anëtare e komisionit,
5. Lumturije Lokaj – Mesimdhenese e femijeve me nevoja të veçanta - anëtare e komisionit.

II. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e kandidatëve në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi.

III. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Zyra e personelit dhe arkivi.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/365
Nr. i faq. 1
Data 11/01/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/04
Datë: 11.01.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kryetari i Komunës me datë: 11.01.2023, merr ketë:

V E N D I M

I. **Për lejimin e qasjeve në SIMFK për vitin 2023.**

Nr.	ID e Përdoruesit	Emri dhe Mbiemri	Emri I klasës funksioanale	Grupi i sigurisë	Qasja e përdoruesit		Numri i Çertifikatës
					I rregullt	Alternativ	
1	AHAMZA	ARTEN HAMZA	5-Pamje Raportim ZKF - OB	636-C	I rregullt		433/2021
2	AHAMZA	ARTEN HAMZA	Moduli i Planit të Parasë së Gatshme	636-C	I rregullt		93/2020
3	SHIQERIEH	SHIQERIE HEBIBI	10-Approving Officer	636-C	I rregullt		06.05.2009
4	FPEPSHI	FLORANT PEPSHI	9-Shpenzim - OB	636-C	I rregullt		06.05.2009
6	ZGJOTA	ZENEL GJOTA	3 - Te hyrat OB	636-C	I rregullt		27.12.2007
7	FLORINDAM	FLORINDA MALOKU	7-Urdher blerje - OB	636-C	I rregullt		16/2015
8	BGAXHERRI	BASHKIM GAXHERRI	8-Pranim i mallit - OB	636-C	I rregullt		178/2016
9	VGAXHERRI	VALBONA GAXHERRI	4-Pasurite - OB	636-C	I rregullt		127/2018
10	VGAXHERRI	VALBONA GAXHERRI	11- Kontrolli buxhetor nenalokimet	636-C	I rregullt		29/2022
11	VTOFAJ	VISAR TOFAJ	5-Pamje Raportim - OB	636-C	I rregullt		332/2011
15	AMALOKU	AVDYL MALOKU	10-Approving Officer	636-C		Alternativ	57/2013
16	DUKAJ	DEME UKAJ	9-Shpenzim - OB	636-C		Alternativ	25.02.2010
17	SUNDIMK	SUNDIM KRASNIQI	6-Zotues - OB	636-C		Alternativ	167/2015
18	SISUFAJ	SARANDA ISUFAJ	8-Pranim i mallit - OB	636-C		Alternativ	35/2019
19	ARTONK	ARTON KRASNIQI	3 - Te hyrat OB	636-C		Alternativ	150/2015

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit.

Me Vendim njoftohen:

1. Të emëruarit në pikën I. të Vendimit,
2. Departamenti i Thesarit - MFPT
3. Arkivi.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/197
Nr. I faq. 1
Data 06/01/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/03
Datë: 30.12.2022

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Shkresës njoftuese të datës 14.12.2022, Kryetari i Komunës me datë 30.12.2022 merr ketë:

VENDIM

I. Formohet grupi punues për klasifikimin e vendeve të punës me përbërje si në vijim:

1. Venera Shala – kryesuese,
2. Vjollca Qestaj – anëtare,
3. Leonora Shehu – anëtare,
4. Arten Hamza - anëtar
5. Turim Ganijaj – anëtar,
6. Demë Ukaj – anëtar
7. Valbona Gaxherri Gacaferi – anëtare,

II. Të përmendurit në pikën I të këtij vendimi, në ketë periudhë ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform legjislacionit në fuqi për fushën përkatëse.

III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtareve të komisionit,
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/336
Nr. i faq.
Data 11/01/2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/02
Datë: 05.01.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale me datë: 05.01.2023, Kryetari i Komunës merr ketë:

VENDIM

I. **z. Demë Ukaj** i sistemuar në pozitën e punës Zyrtar Administrativ Financiar në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale, caktohet **zëvendësues i Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,** nga data: 01.01.2023, që të punoj me kompetenca dhe pergjegjesi të plota.

II. I lartpërmenduri në pikën I të këtij vendimi, në ketë periudhë ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform legjislacionit në fuqi për fushën përkatëse.

III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- z. Demë Ukaj,
- Zyra e Personelit,
- Drejtoria për SHMS,
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA
JUNIK

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 1-180/184
Nr. i faq. 1
Data 06/01/2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/01
Datë:05.01.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 4, 5 dhe neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 83 paragrafi 10 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kryetari i Komunës me datë: 05.01.2023 merr ketë:

VENDIM

I. Përfundohet marrëdhenia e punës së ushtrueses së detyrës **Znj. Lumturije Krasniqi** me Nr. personal. në pozitën e punës **Koordinatore e SISH-it, në QKMF „ Dr.Ali Hoxha"** në Junik nga data 01.01.2023, dhe njëkohësisht e njejta kthehet në pozitën e mëparshme të punës Infermiere – Zyrtare e SISH-it, sipas Kontratës së punës të datës: 07.06.2019.

II. E permendura në pikën një (I) të këtij Vendimi do të ketë koeficientin e pagës sipas titullit të vendit të punës **Infermiere – Zyrtare e SISH-it.**

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Udhëheqësja e personelit,
- Pala,
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/OFFICE OF THE MAYOR
JUNIK

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu